



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1739/2 prot

Datë 01.07.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-05441-05-20-2024 me objekt “*Loti 4, Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatin Maglum 800 / ose ekuivalent i tij*” me fond limit 7 260 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1.
- Ankimues:** Operatori Ekonomik “GENIUS” SHPK, me NUIS K63121801C, me adresë: Lagjja Nr.3, Rruga Jurgen Trade, Laboratori perballe ish Spitalit, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1, me adresë: Rr. “Vllazen Huta”, Tirane.
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, me NUIS K81323024G, me adresë Njesia Bashkiake nr.11, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesha 92, seksioni 4, Hyrja 28, Kodi Postar 1026, Tirane

Në datën 28.06.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1739/2024 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4265 e operatorit ekonomik “GENIUS” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-05441-05-20-2024 me objekt “*Loti 4, Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatin*”

Maglum 800 / ose ekuivalent i tij” me fond limit 7 260 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret që operatori ekonomik “GENIUS” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga shoqëria “Sëissmed” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr.1739 prot., datë 28.06.2024.

Konkretisht në ankesë pretendohet për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK, të kriterëve si më poshtë vijon:

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

a. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 8

Kapaciteti teknik:

2.8.6 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 1 inxhinier te diplomuar ne profilin Inxhinieri Elektronike/ Elektrike/ Mekanike/ Informatike/ Mjekesore, gjithashtu te jete i trajnuar per pajisjet laboratorike i cili eshte objekt prokurimi (Maglium 800 Imunologji/ ekuivalent i tij) pasi do te jete pergjegjes per instalim, trajnim te stafit mjekesore dhe kalibrimin e marterialeve.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve, të gjithë dokumentacionin provues si, kontratën e punës se inxhinierit, diplomën përkatëse, certifikaten e trajnimit te inxhinierit nga kompania prodhuese i cili te vertetoje qe eshte i trajnuar per perdorimin e aparatit objekt prokurimi (Maglum 800/ ekuivalent i tij) si dhe listëpagesën e shoqërisë për muajt e fundit për vetëdeklarimet mbi punonjësën (inxhinierin) e kërkuar në DST.

2.8.11 Ne datën e hapjes së procedurës, në orën 09:00 ofertuesit duhet të paraqesë, pranë Laboratorit të Qendres Shëndetësore të Specialiteteve nr.1, mostra e artikujve që prokurohen, për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave. Mostrat të jenë të shoqëruara me një listë inventari (procesverbal) të firmosur dhe vulosur, ku të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrat e administruara.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 01.07.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri